

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Gjatë muajit janar, Bordi i ERE-s ka zhvilluar 5 mbledhje, që kanë rezultuar në 42 vendimmarrje, ndër të cilat:

1.Licencimin e shoqërive "ZENINA" shpk, "Sunny Side Energy" shpk, "Samasol" shpk, "Rebesol" shpk dhe "3AD Energy" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, "DESLA" shpk në veprimtarinë e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike; si dhe "MET Albania" sha në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike.

2.Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërive:

- "EB ENERGY" shpk, "GREEN PLUS ENERGY" shpk, "GRABOVA HYDROPOWER" sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike;
- "VOLTON" shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë "GEGA-G" shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 64, datë 08.04.2020.

3.Mbi kërkesa të ndryshme nga të licencuar:

- Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "5GX ENERGY" shpk për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve fikse të krijuara apo që do të krijohen të shoqërisë "5GX ENERGY" sh.p.k, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "BANKA E TIRANËS" sha.
- Dhënien e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik "Blue 1", i shoqërisë "SPV BLUE 1" shpk, për periudhën 01 – 31 tetor 2024, për sasinë 847,6 MWh.

Në këtë gazetë do të lexoni mbi

Licencime të muajit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

Fillime të procedurave për licencim

Zgjatje të afateve vendimmarrëse

Tarifa dhe çmime

Seanca dëgjimore

Platforma PCT

Konsultime

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Mbi përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për aktivitetet e rregulluara:

1. Shqyrtimin e kërkesës së ardhur nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sha, mbi ndryshimin e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë si dhe rivlerësimin e kostove të FSHU sha që përcaktojnë këtë çmim nga data 1 Shkurt 2025, dhe përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë për periudhën 1 Shkurt 2025 – 31 Dhjetor 2025, për konsumatorët që furnizohen në kushtet e furnizimit universal si më poshtë:

- Për konsumatorët familjarë që konsumojnë më pak se 700 kWh në muaj – 8.5 Lekë/kWh pa TVSH.
- Për konsumatorët familjarë që konsumojnë 701 kWh në muaj, e më tej – 9.5 Lekë/kWh pa TVSH për të gjithë sasinë e konsumuar duke filluar nga kilovati i parë.

2. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2024 prej 18.77 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Vendime të tjera si:

1. Fillimin e procedurës për disa ndryshime në rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike.
2. Përlllogaritjen e mbështetjes financiare që duhet të dokumentojnë në ERE subjektet që aplikojnë për t'u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike. ERE përcaktoi detyrimin e dokumentimit të mundësisë për mbështetje financiare për të paktën 1 muaj të veprimtarisë, duke u bazuar në çmimin mujor të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX, që i korrespondon muajit që i paraprin datës së aplikimit.

3. Pranimin e kërkesës së shoqërisë "GEN-I Tirana" shpk për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241 datë 15.11.2024 dhe fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e disa propozimeve për ndryshime "Mbi vendosjen e detyrimit të publikimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në tregun e lirë".



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Seancë dëgjimore në lidhje me diskutimin mbi propozimin e ardhur nga GEN-I shpk për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 241 të datës 14.11.2024 “Mbi vendosjen e detyrimit të publikimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e Furnizimit në Tregun e Lirë”.

U zhvillua më datë 29.01.2025, në ambjentet e ERE-s një seancë dëgjimore me qëllim diskutimin mbi propozimin e ardhur nga GEN-I shpk për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 241 të datës 14.11.2024 “Mbi vendosjen e detyrimit të publikimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në tregun e lirë” sipas të cilit të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në treg të lirë, kanë detyrimin të publikojnë ofertat e furnizimit dhe të përcaktojnë afatet e vlefshmërisë për çdo ofertë të publikuar, duke filluar nga data 02.12.2024.

Në seancë ishin të pranishëm përfaqësues të KESH sha, AEES – Shoqata e furnizuesve të energjisë elektrike, FTL sha, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit si dhe disa nga furnizuesit të cilët aktualisht janë në treg të lirë. Palët diskutuan mbi propozimin e GEN - I mbi detyrimin për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike vetëm nga të licencuari në aktivitetin e furnizimit që furnizojnë familjet dhe mikro - ndërmarrjet me konsum vjetor më të ulët se 100,000kWh në PCT, si dhe përjashtimin e furnizuesve që furnizojnë konsumatorë të lidhur në tension të mesëm dhe të lartë nga detyrimi i publikimit të ofertave në Platformën e Krahasimit të Çmimeve të Energjisë Elektike.

Gjatë muajit janar janë zhvilluar gjithashtu edhe 7 seanca dëgjimore, me konsumatorë por dhe të licencuar, me qëllim sqarimin e detajeve të nevojshme për zgjidhjen e ankesave përkatëse, apo vazhdimin e procesit të licencimit të subjektit në fjalë, por dhe me subjekte të licencuar me qëllim sqarimin dhe diskutimin në lidhje me dokumentacionin e munguar të aplikimit për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me regjistrat e [licencimit të subjekteve, të garancive të origjinës](#) dhe të [ankesave](#) të përditësuar , si dhe [tarifat dhe çmimet](#) të miratuara nga ERE. Po ashtu në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, neni 19, gërma k), gjenden të publikuara në faqen e internetit të dhëna katërmujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike. (<https://www.ere.gov.al/sq/tregu-i-energjisë/raporte-dhe-te-dhëna-te-tregut-te-energjisë-elektrike>)

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Konsultime

ERE në janar ka nisur konsultimin mbi “[Mbi disa ndryshime ne draft marrëveshjen për blerjen e energjisë elektrike ndërmjet Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë](#)”. Palët e interesit i gjejnë të publikuara propozimet per ndryshime në linkun <https://ere.gov.al/sq/publiki-me/konsultime/vendim-nr-302-date-30-12-2024-mbi-shqyrtimin-e-propozimit-te-ftl-sh-a-per-draft-marreveshjen-per-blerjen-e-energji-se-elektrike-ndermjet-furnizuesit-te-tregut-te-lire-sh-a-dhe-prodhuesve-me-perparesi-te-energji-se> dhe janë të mirëpritura të dërgojnë opinionet e tyre në adresën erealb@ere.gov.al, brenda 20 ditësh pune nga data e publikimit.

Njoftim për Klientët në treg të lirë

Mbi furnizimin nëpërmjet “Furnizuesit të Mundësisë së Fundit” dhe përdorimi i Platformës së krahasimit të çmimeve PCT.

Gjithashtu risjellim në vëmendje që, të gjithë konsumatorët që kanë plotësuar kriteret për daljen në treg të lirë dhe që nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre, mund të përfitojnë nga furnizimi nëpërmjet “Furnizuesit të Mundësisë së Fundit” i cili është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e ligji të sektorit të energjisë elektrike, dhe që ofron për një periudhë të kufizuar kohe (60 ditë) shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara. E drejta për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin është e garantuar me ligj. Ju ftojme të shfletoni platformën e krahasimit të çmimeve PCT (Price Comparison Tool), të ndërtuar nga ERE <https://pct.ere.gov.al/>, ku mund të kërkontë dhe gjeni ofertat me të mira të furnizimit për kategorinë së cilës i përkisni.

